

## NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

### PROJEKTLIGJI “PËR MBLEDHJEN, PËRPUNIMIN, TRANSMETIMIN, RUAJTJEN, FSHIRJEN, MBROJTJEN DHE GARANTIMIN E TË DHËNAVE TË INFORMACIONIT TË PASAGJERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Ministria e Brendshme fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për mbledhjen, përpunimin, transmetimin, ruajtjen, fshirjen, mbrojtjen dhe garantimin e të dhënave të informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”.

Ministria e Brendshme mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektaktit, kryesisht mbi:

- Të dhënat e pasagjerit;
- Kompetencat e institucioneve përgjegjëse që kanë të drejtë akses në të dhënat e pasagjerit në RSH.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektligjit.

Ministria e Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë 20 ditë pune, nga data 4 nëntor 2024 deri më 2 dhjetor 2024.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrin Elektronik për projektligjit, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>;
- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinorit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, Sara Shameti, në adresën: [Sara.Shameti@mb.gov.al](mailto:Sara.Shameti@mb.gov.al)

## Kontakti:

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

Znj. Sara Shameti - Koordinatore e Konsultimit Publik, e-mail: [Sara.Shameti@mb.gov.al](mailto:Sara.Shameti@mb.gov.al)

Znj. Gerzheta Akshia - Specialiste e Sektorit të Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore.

## Datat dhe vendet e takimeve publike:

Më 20 shkurt 2024, në orën 11:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, u zhvillua takimi i grupit të punës për vlerësimin paraprak të nismës për propozimin e projektligjit “Për përpunimin e informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”, i ngritur me Urdhër të Ministrit të Brendshëm nr. 22, datë 19.01.2024, “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin paraprak të nismës për propozimin e projektligjit “Për përpunimin e informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”.

Në hapje të këtij takimi, Kryetari i grupit të punës vlerësoi nismën për propozimin e projektligjit “Për përpunimin e të dhënave të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”, duke rikujtuar detyrimet që rrjedhin nga urdhri i ministrit të Brendshëm nr. 22, datë 19.01.2024. Grupi i punës u përqëndrua për realizimin brenda afatit të detyrave të Urdhrit, si mëposhtë:

- a) të vendosë dhe miratojë përmbajtjen e raportit të vlerësimit (RIA);
- b) të miratojë tabelat e përputhshmërisë për çdo acqui të BE që synohet të përafrohet;
- c) t’i propozojë ministrit çështjet që duhen rregulluar, format e pjesëmarrjes dhe hapat kryesore të realizimit dhe bashkërendimit të procesit legjislativ, afatet përkatëse për realizimin e tyre, strukturat përgjegjëse, si dhe burimet njerëzore dhe materiale që ngarkohen të bashkëpunojnë me strukturën juridike për hartimin e këtij projekt akti.

Në vijim, referuar Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 80, datë 07.05.2024, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për përpunimin e informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”, u thirr mbledhja e parë të Grupit të Punës dhe të Grupit Teknik të Punës, më datë 31 maj 2024, ora 12:00 – 13:00, në mjediset e Ministrisë së Brendshme.

Në këtë mbledhje u diskutua përmbajtja e draftit paraprakt të projektligjit, u vendosën afatet për hartimin e tabelave të përputhshmërisë, RIA-s si dhe relacionit shpjegues.

Mbledhjet e tjera me qëllim finalizimin e praktikës u zhvilluan me datë 20 shkurt 2024, si dhe datë 01 tetor 2024, nga ku u diskutuan me gjerë dispozitat e projektaktit, dhe akteve shoqëruese.

## Sfondi i propozimit legjislativ

Projektligji “Për mbledhjen, përpunimin, transmetimin, ruajtjen, fshirjen, mbrojtjen dhe garantimin e të dhënave të informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”, ka për qëllim të qartësojë kompetencat e autoriteteve kompetente dhe të SIP-it.

Miratimi i projektligjit paraqet disa avantazhe, ndër të cilat përmendim:

- Garantimi i sigurisë juridike, duke plotësuar boshllëqet e lëna nga Ligji nr. 71/2016 “Për kontrollin Kufitar”, i ndryshuar;
- Parashikim i detajuar i elementeve, duke shmangur kështu numrin e madh të dispozitave referuese dhe të akteve nënligjore të dala në kuadër të rregullimit të funksionimit dhe organizimit të API dhe PNR.
- Garantimi i pavarësisë së API - PNR.
- Garantimi i sigurisë të të dhënave të pasagjerit, pasi këto të dhëna do të transmetohen, përpunohen dhe përdoren vetëm nga një autoritet që ky ligj do të përcaktojë si pikën e vetme e marrjes, grumbullimin, analizimin dhe përdorimit të të dhënave të pasagjerit.
- Përcaktimi i qartë i përgjegjësisë të Sektorit të Inteligjencës së Pasagjerit.
- Përkatimi i autoriteteve kompetente që kontribuojnë në mbarëvajtjen e punës së Sektorit të Inteligjencës së Pasagjerit.
- Përkatimi i autoriteteve kompetente të cilat kanë të drejtë të kërkojnë, të konsultojnë, të marrin të dhënat e pasagjerit ose rezultatet e përpunimit të tyre, me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin e ndjekjen penale të veprave penale. Garantimi i efikasitetit të veprimeve hetimore gjyqësore dhe zgjidhjes së çështjeve hetimore lidhur me veprimtarinë kriminale e konflikteve civile.
- Saktësimi i kompetencave të Autoritetit Kombëtar Mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave të pasagjerit.
- Konsolidimi i normave, që kanë për objekt të dhënat API dhe PNR.

## Propozimet

Në projektligj do të përcaktohen qartë cilat janë të dhënat e pasagjerit duke specifikuar, të dhënat paraprake (API) dhe ato të regjistrimit të emrit të pasagjerit (PNR), si edhe do të shtohet që specialistët e S.I.P regjistrojnë edhe manualisht edhe automatikisht në bazën e të dhënave të pasagjerit, të paktën veprimet e mëposhtme të përpunimit të të dhënave, që kanë të bëjnë me:

a) mbledhjen; b) përpunimin; c) transmetimin; ç) shkëmbimin për përdorimin kombëtar dhe ndërkombëtar; d) ruajtjen; dh) fshirjen/ shkatërrimin; e) pseudonimizimin dhe/ose anonimizimin e të dhënave; ë) mbrojtjen dhe garantimin e të dhënave.

Në projektligj janë parashikuar edhe autoritete të tjera përveç atyre aktuale bazuar në kërkesat e institucioneve përkatëse si prokuroritë apo gjykatat, përfshirë edhe ato të posacme.

## Pyetjet

*Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projektligjit të propozuar. Për më tepër, ne kemi zgjedhur pyetjet e mëposhtme ku kontributi juaj do të jetë veçanërisht i vlefshëm, dhe të cilave mund t'i përgjigjeni duke plotësuar një pyetësor të shkurtër në internet.*

- Si mendoni se mund të ndikojë ky ligj i ri në sigurimin e të dhënave të pasagjerit API/PNR, në Republikën e Shqipërisë?
- A mendoni se garantohet zbatimi i ligjit mbi përcaktimin e organeve përgjegjëse që kanë të drejtë akses në API/PNR?